



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.2  
Dhjetor 2024

## PJESËMARRJA E SHQIPËRISË NË SKUADRA TË PËRBASHKËTA HETIMORE ME AGJENCITË LIGJZBATUESE TË BASHKIMIT EUROPIAN

**Maend Kullaj\***

*\*Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative, Fakulteti i Shkencave Shoqërore,  
Albanian University*

### **Abstrakt**

Një emërues i përbashkët i Bashkimit Europian dhe shteteve të treta është vullneti për të luftuar kriminalitetin e rëndë, veçanërisht atë në formën e organizuar, i cili nuk njihet kufij shtetërorë. Krijimi dhe funksionimi i organeve ligjzbatuese të pavarura në nivel europian si EUROPOL, EUROJUST, FRONTEX, OLAF, dhe më rishtasi, Zyra e Prokurorit Publik Europian (EPPO), secili me rregulloren përkatëse, dëshmon për këtë qëllim të përbashkët, por nuk siguron, në vetvete, përfshirjen në këtë rrjet bashkëpunimi të shteteve candidate për anëtarësim si Shqipëria, të cilës i burojnë nga MSA-ja detyrime bashkëpunimi në çështjet penale. Në pamundësi të zbatimit të drejtpërdrejtë të *acquis* përkatëse, qëllimi i këtij punimi është që të evidentojë kuadrin normativ që mundëson bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale, specifikisht në formën e ngritjes së skuadrave të përbashkëta hetimore, ndërmjet autoriteteve shqiptare dhe shteteve anëtare, me mbështetjen dhe pjesëmarrjen edhe të agjencive ligjzbatuese të BE-së. Nëpërmjet metodave cilësore, punimi analizon instrumentet kryesore të bashkëpunimit ndërmjet palëve dhe nivelin e zbatueshmërisë së tyre, duke paraqitur pozitën e autoriteteve shqiptare në operacione dhe kontributin e tyre real në veprimtarinë e përbashkët hetimore kundër krimit ndërkufitar, bazuar edhe në shembuj çështjesh konkrete. Në fund të analizës punimi arrin në përfundimin se, Republika e Shqipërisë, në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit me këto agjenci, ka një rol dhe pozitë të barabartë si anëtar i skuadrave të përbashkëta hetimore njëloj si çdo shtet anëtar i BE-së, duke shërbyer këto marrëveshje si një kuadër rregullator për këtë veprimtari deri në momentin e anëtarësimit të plotë.

**Fjalë çelës:** *skuadra të përbashkëta hetimore; krim ndërkufitar; bashkëpunim ndërkombëtar në çështjet penale; Shqipëri; Bashkimi Europian; EPPO*

## THE PARTICIPATION OF ALBANIA IN JOINT INVESTIGATION TEAMS WITH LAW ENFORCEMENT AGENCIES OF THE EUROPEAN UNION

### Abstract

A common denominator of the European Union and third countries is the resolve to fight serious criminality, especially organised one, which recognises no borders. This common objective is demonstrated by the creation and activity of independent law enforcement bodies at the European level such as EUROPOL, EUROJUST, FRONTEX, OLAF, and more recently, The European Public Prosecutor's Office (EPPO), each with its own regulation, but not guaranteeing, in itself, the involvement in this cooperation network of candidate countries like Albania, which has obligations arising from the SAA to cooperate in criminal matters. Unable to directly apply the relevant *acquis*, this paper aims to identify the regulatory framework which enables international cooperation in criminal matters, specifically in the form of the establishment of joint investigation teams between Albanian authorities and member states, along with the support and participation of EU law enforcement agencies. Through qualitative methods, the paper analyses the main cooperation instruments between parties and their level of applicability, by presenting the position of Albanian authorities during operations and their real contribution in the mutual investigative activity against cross-border crime, based also on examples of real cases. At the end of the analysis the paper concludes that, The Republic of Albania, due to the cooperation agreements with these agencies, has an equal role and position as a member of joint investigation teams the same as any member state of the EU, and these agreements serve as a regulatory framework for this activity until its full accession.

**Keywords:** *joint investigation teams; cross-border crime; international cooperation in criminal matters; Albania; European Union; EPPO*

### Hyrje

Zhvillimet e shumta dhe të shpejta shoqërore, ekonomike, dhe veçanërisht teknologjike, krahas dobive të sjella, u kanë dhënë mundësinë elementëve kriminal për t'u zgjeruar, fuqizuar dhe sofistikuar. Realiteti tashmë është se kriminaliteti i rëndë nuk njih më kufij shtetërorë, dhe kjo ndihet akoma më tepër në regjimin e lirisë së lëvizjes brenda Bashkimit Europian. Nga ana tjetër, organet ligjzbatuese të shteteve kanë përgjegjësinë që të ndjekin ritmin, hapat e krimit, madje edhe të jenë një ose disa hapa përpara tij; kur nuk njih krimi kufij, as ligji nuk njih më kufij, kur sofistikohet krimi, po aq duhet edhe ligji, dhe kur bashkëpunon krimi, në të njëjtën mënyrë duhet të bashkëpunojë edhe ligji.

Në përpjekjet për të arritur anëtarësimin në BE, këtë rrugë po përpiqet të ndjekë edhe Shqipëria, kriminaliteti i së cilës njihet dhe shtrihet në rajon e më gjerë. Gjithnjë e më tepër po përdoren nga prokuroria dhe policia jonë të ashtuquajturat “metoda speciale të hetimit”, si një përgjigje efektive ndaj krimit të organizuar, veçanërisht atij ndërkufitar, shpeshherë duke braktisur metodat tradicionale. Një ndër këto metoda të sofistikuar është edhe “Skuadra e Përbashkët Hetimore” (në vijim, “SPH”), kur shtetet bëhen bashkë si një njësi e vetme me një qëllim – mposhtjen e kriminalitetit që prek teritoret e tyre.

Bashkëpunimi ndërkombëtar në çështjet penale ka marrë një vëmendje akoma më të gjerë nga veprimtaria e agjencive ligjzbatuese të BE-së si Eurojust, mandati i së cilës mbulon pikërisht këtë lloj bashkëpunimi, në veçanti në rajon edhe me projektin e zbatuar rishtasi, “Drejtësia Penale në Ballkanin Perëndimor”. Madje, në sajë të nismës dhe koordinimit të Eurojust, tashmë është arritur krijimi për herë të parë i një SPH-je me pjesëmarrjen edhe të organizmave si Zyra e Prokurorit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare në Hagë, për hetimin mbi luftën në Ukrainë.

Megjithatë, në praktikën e SPH-ve evidentohen një sërë problematikash, si mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit të hershëm ndërinstytucional, vonesat gjatë hetimeve paralele, kufiri i shtrirjes së juridiksionit të autoriteteve të huaja, por edhe çështje fillestare si baza ligjore për ngritjen e një SPH-je ndërmjet shteteve anëtare dhe jo-anëtare të BE-së, veçanërisht me pjesëmarrjen e agjencive si Europol dhe Eurojust, ku mbështetja e këtyre të fundit tashmë ndihmon në kapërcimin e shumë prej këtyre pengesave në ndjekje të drejtësisë.

## 1. Kuptimi dhe natyra e SPH-ve

Për Shqipërinë, njëloj si për shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor, ndër fushat për të cilat detyrohet të bashkëpunojë me rajonin në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) që prej korrikut të vitit 2006, një vend të rëndësishëm e zë edhe bashkëpunimi ndërkombëtar në çështjet penale sipas Titullit VII, me qëllim luftimin dhe parandalimin e krimeve të rënda. Praktika njeh dhe zbaton forma të ndryshme të kësaj ndihme të ndërsjellë juridike e cila kryesisht ka natyrë gjyqësore, të realizuar në sajë të një “fryme solidariteti” midis shteteve (Hoxha, 2011, f. 21). Format më të përdorura janë ekstradimi, ekzekutimi i vendimeve penale të huaja, transferimi i procedimeve dhe letërporosia.

Nga ana tjetër, qëllimi i bashkëpunimit mund të jetë edhe realizimi i interesave të përbashkëta për disa shtete, siç është adresimi i kriminalitetit ndërkufitar, veçanërisht i atij të organizuar dhe terrorizmit, që prek territoret e tyre. Metoda e bashkëpunimit që ndiqet në këto raste është krijimi i një SPH-je me pjesëmarrjen kryesisht të autoriteteve gjyqësore dhe ligjzbatuese të shteteve që bashkëpunojnë, dhe me qëllimin e posaçëm për të kryer hetime penale të përbashkëta në territorin e një apo disa shteteve të përfshira. SPH, si një metodë mjaft e avancuar dhe efektive bashkëpunimi, është shenja më e prekshme e heqjes së kufijve midis juridiksioneve (Geraci, 2022, f. 35), si përgjigje ndaj mosnjohjes së kufijve edhe nga krimi, veçanërisht brenda Bashkimit Europian (Pradel, et al., 2009, f. 47).

SPH ka një natyrë hibride, duke qenë se një skuadër mund të përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve hetimore të shteteve të interesuara për të hetuar bashkërisht, por tashmë në të mund të marrin pjesë dhe të ofrojnë mbështetje logjistike dhe operacionale edhe përfaqësues të agjencive ligjzbatuese të BE-së si Europol, Eurojust, Frontex, Olaf, dhe EPPO, brenda mandatit të tyre, duke punuar të gjithë nën një drejtim të njësuar (Geraci, 2022, f. 32). E krijuar nëpërmjet nënshkrimit të një marrëveshjeje formale të posaçme ndërmjet palëve dhe me një kohëzgjatje të caktuar, një SPH e ushtron veprimtarinë hetimore në koordinim të plotë dhe në përputhje me modalitetet e marrëveshjes, duke shkëmbyer informacion operacional, mbledhur e shkëmbyer drejtpërdrejt prova dhe veprime të tjera hetimore në terren, me të njëjtë vlerë provuese dhe përdorshmëri në çdo juridiksion.

Në veçanti evidentohet roli i Eurojust, si Agjencia e BE-së për Bashkëpunimin në Drejtësinë Penale, i cili identifikon çështjet e përshtatshme për krijimin e një SPH-je; të drejtën e zbatueshme dhe informacione mbi sistemet e ndryshme të drejtësisë; ndihmon në hartimin e marrëveshjes së SPH-së, ku tashmë ka edhe një marrëveshje model të miratuar; organizon mbledhje koordinuese për palët; si dhe, ofron mbështetje financiare për veprimtarinë e SPH-ve (Ndoci, 2018, f. 125). Po kështu, që prej vitit 2005 funksionon Rrjeti i Ekspertëve Kombëtarë për SPH-të në nivel europian me qëllim nxitjen e përdorimit të SPH-ve dhe ofrimin e ndihmës për aktorët e përfshirë, me mbështetjen e Europol dhe Eurojust. Në parim, kërkesa për krijimin e një SPH-je është “vullnetare” ndërmjet shteteve të interesuara, por mund të jetë edhe “e nxitur” nga Eurojust në varësi të çështjes konkrete (Geraci, 2022, f. 32).

Sa i përket anës operacionale, SPH-të e ushtrjnë veprimtarinë hetimore në përputhje me *lex loci*, pra me legjislacionin e shtetit apo shteteve anëtare të skuadrës në territorin e të cilëve po ndërmerren veprimet hetimore – një zgjidhje kjo, e cila “barazpeshon nevojat e bashkëpunimit ndërkombëtar me ruajtjen e sovranitetit të shtetit në territorin e të cilit po kryhen hetimet” (Geraci, 2022, f. 34).

## 2. Ligjshmëria e SPH-ve

Një çështje mjaft e rëndësishme që duhet marrë në konsideratë është edhe baza ligjore për ngritjen e një SPH-je, apo ndryshe, instrumenti i bashkëpunimit që do të përdoret, veçanërisht në rastet e bashkëpunimit të shteteve anëtare të BE-së dhe agjencive të saj, me vendet e treta si Republika e Shqipërisë, duke marrë parasysh pamundësinë për të zbatuar drejtpërdrejt *acquis communautaire* përkatëse nga kjo e fundit.

Si bazë ligjore për SPH-të mund të shërbejnë kryesisht:

- marrëveshje ndërkombëtare shumëpalëshe;
- marrëveshje ndërkombëtare dypalëshe; ose
- legjislacioni kombëtar.

Në rastin e marrëveshjeve shumëpalëshe evidentohen konventat e OKB-së si, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkufitar (Konventa e Palermos, 2000), neni 19; Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope (Konventa e Vienës, 1988), neni 9; apo Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, neni 49; të ratifikuara edhe nga Republika e Shqipërisë. Megjithatë, instrumentet e OKB-së nuk parapëlqehen duke qenë se dispozitat e tyre për SPH-të përgjithësisht konsiderohen si “klauzola lejuese”, pasi janë shumë më pak të detajuara dhe lënë mjaft çështje për t’u zgjidhur me marrëveshjen e veçantë për krijimin e SPH-së (Eurojust, 2022a, f. 4). Në nivel rajonal përmendet Konventa e Bashkëpunimit Policor në Europën Juglindore, e ndryshuar, neni 27.

Instrumenti shumëpalësh më gjithëpërfshirës sa i përket SPH-ve që vjen nga Këshilli i Europës është Protokollin i Dytë Shtesë i Konventës Europiane për Ndhimën e Ndërsjellë në Çështjet Penale (në vijim, “Protokollin i Dytë Shtesë”), dhe konkretisht neni 20 i tij, miratuar në vitin 2001 dhe ratifikuar nga Shqipëria 1 vit më vonë. Vlen të përmendet se, përmbajtja e Protokollit të KiE-së është thuajse identike me dy instrumentet kryesore të BE-së, konventën e vitit 2000 për ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet penale dhe vendimin kuadër të vitit 2002 për SPH-të (Eurojust, 2022a, f. 4), duke njësuar kështu parashikimet ndërmjet shteteve anëtare dhe jo-anëtare të BE-së dhe duke lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet tyre. Krijimi i SPH-ve parashikohet edhe në nenin 12 të Protokollit të Dytë Shtesë të Konventës për Krimin Kibernetik për rritjen e bashkëpunimit dhe zbulimin e provave elektronike, miratuar në nëntor të vitit 2021 dhe ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 71, datë 20.10.2022.

Në raport dypalësh për krijimin e SPH-ve vlen të përmendet neni 10 i marrëveshjes ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë të ratifikuar me ligjin nr. 9871, datë 11.02.2008. Në veçanti, marrëveshje dypalëshe bashkëpunimi janë lidhur edhe me një sërë agjencish ligjzbatuese të BE-së, dhe konkretisht: Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Europol për Bashkëpunimin Strategjik dhe Operacional, neni 18, ratifikuar në vitin 2014 dhe ndryshuar, si dhe Marrëveshja e vitit 2018 për vendosjen e oficerëve ndërlidhës të Europol në Shqipëri; Marrëveshja e Bashkëpunimit me Eurojust e vitit 2018, ku vlen të veçohet emërimi dhe riemërimi i mëpasshëm nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë i një prokurori ndërlidhës shqiptar pranë Eurojust, si një pikë kontakti qendrore për SPH-të (në vitet 2020 dhe 2023); tre Marrëveshjet me Agjencinë e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Europian (Frontex), ratifikuar respektivisht në vitet 2019, 2021, dhe 2024; Marrëveshja e Bashkëpunimit e vitit 2022 ndërmjet Zyrës së Prokurorit Publik Europian (EPPO) dhe Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, neni 6, ku bëhet referim te Protokollin i Dytë Shtesë, dhe ku parashikohet edhe mundësia e dërgimit nga Prokuroria e Përgjithshme të një oficeri ndërlidhës pranë EPPO-s; dhe së fundi, por natyrshëm jo për nga rëndësia, Marrëveshja e Punës e vitit 2023 ndërmjet Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe EPPO-s, neni 6, ku bëhet referim te instrumente të OKB-së dhe te Protokollin i Dytë Shtesë, dhe ku sërish parashikohet edhe mundësia e dërgimit nga SPAK të një

oficeri ndërlidhës pranë EPPO-s.

Këto marrëveshje synojnë të përforcojnë më shumë bashkëpunimin operacional ndërmjet vendeve kandidate për anëtarësim si Shqipëria dhe agjencive ligjzbatuese të BE-së, si dhe të mundësojnë përfaqësimin e tyre në këto agjenci me të drejta të plota njëlloj si shtetet anëtare. Në këtë drejtim, vlen të përmendet nxitja e përdorimit të SPH-ve në veçanti, me projektin e shtatorit të vitit 2022 “Projekti i Drejtësisë Penale në Ballkanin Perëndimor” (WBCJ), të zbatuar nga Eurojust, për përforcimin e bashkëpunimit ndërkufitar në drejtësinë penale në Ballkanin Perëndimor, për të luftuar krimin e organizuar dhe terrorizmin që prek rajonin dhe BE-në (Eurojust, 2022b, f. 1). Nuk ekziston ndonjë pengesë ligjore për përdorimin e SPH-ve me shtetet e këtij rajoni, në veçanti me ato që kanë lidhur një marrëveshje bashkëpunimi me Eurojust, siç është rasti i Shqipërisë (Eurojust, 2024, f. 6); përkundrazi, krijohen një sërë lehtësirash praktike.

Legjislacioni kombëtar si bazë ligjore për krijimin e SPH-ve zgjidhet vetëm në mungesë të instrumenteve ndërkombëtare të përbashkëta të bashkëpunimit, edhe pse vlen të shqyrtohet nëse e drejta kombëtare përmban parashikime specifike lidhur me SPH-të. Në rastin e Shqipërisë, vlen të evidentohet ligji nr. 97/2021, datë 07.07.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10193, datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale””, të ndryshuar, me të cilin është shtuar posaçërisht Kreu V/1 “*Skadrat e përbashkëta hetimore*” (nenet 75/1 deri 75/6) ku parashikohet procedura përkatëse në ngjashmëri me nenin 20 të Protokollit të Dytë Shtesë.

Kështu, me propozimin e prokurorit të një procedimi penal të regjistruar, drejtuesi i prokurorisë përkatëse nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm, ose vetë drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, mund të kërkojnë krijimin e një SPH-je në rastet kur:

- a) veprimtaria hetimore për një vepër penale kërkon kryerjen e veprimeve veçanërisht komplekse ose të vështira dhe që kanë lidhje edhe me një shtet tjetër; ose
- b) një ose disa shtete të tjera janë duke kryer hetime për vepra penale për të cilat rrethanat e çështjes kërkojnë kryerjen e veprimeve hetimore të bashkërenduara ose të përbashkëta në të gjitha vendet e tjera.

Kërkesa duhet të përmbajë, krahas informacioneve të parashikuara në nenin 14 të Konventës Europiane për Ndihmën e Ndërsjellë, edhe propozimin për përbërjen e SPH-së konkrete dhe kohëzgjatjen e saj.

Komunikimet me autoritetet e huaja në këtë rast bëhen nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, dhe kur kërkesa për krijimin e një SPH-je vjen nga vetë autoriteti i huaj, ministri ka të drejtën e vendimarrjes, për t’i dhënë rrugë, ose për ta refuzuar kërkesën kur çmon se veprimet e kërkuara rrezikojnë sovranitetin, sigurimin ose interesa të rëndësishme të shtetit, apo kur del e qartë se veprimet e kërkuara janë të ndaluara shprehimisht nga ligji ose kur vijnë në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik shqiptar. Një kontroll politik i tillë nga qeveria shqiptare eventualisht mund të bëhet pengesë për arritjen e bashkëpunimit gjyqësor në çështje konkrete, duke i vendosur organet ligjzbatuese shqiptare në një pozitë më pak të favorshme në raport me partnerët e huaj.

Neni 75/3 përmban parashikime edhe për elementet e marrëveshjes së SPH-së, e cila nënshkruhet nga drejtuesi i prokurorisë përkatëse dhe ai i autoritetit ose autoriteteve kompetente të huaja. Marrëveshja duhet të përmbajë përbërjen e SPH-së, ku në rastin e Shqipërisë përfaqësuesit e prokurorisë mund të jenë prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore, hetues ose punonjës të tjerë të Policisë së Shtetit; drejtuesin e SPH-së, i cili zgjidhet nga anëtarët e saj; objektin dhe qëllimin e SPH-së; dhe, afatin brenda të cilit duhet të përfundojë veprimtaria hetimore. Marrëveshjes duhet t’i bashkëlidhet edhe plani i veprimeve hetimore, i cili përmban dhe masat organizative, si dhe mënyrën e zbatimit të tij. Këto elemente parashikohen edhe në Marrëveshjen Model për Krijimin e një SPH-je të miratuar në vitin

2022 me rezolutë të Këshillit të BE-së, së bashku me parashikime të tjera më të detajuara, ku krahas *anëtarësisë* në skuadër nga shtetet, parashikohet edhe *pjesëmarrja* mbështetëse dhe këshilluese e agjencive si Europol, Eurojust, dhe Olaf.

Në mungesë të një baze ligjore të vetme të përbashkët, një zgjidhje praktike e gjetur nga praktikuesit e SPH-ve është “ndërthurja e instrumenteve të bashkëpunimit” (Eurojust, 2022a, f. 6), siç ishte rasti i marrëveshjes ndërmjet SPAK dhe EPPO apo edhe rasti i Marrëveshjes Model.

### 3. Bilanci i punës së SPH-ve në Shqipëri

Pjesëmarrja e Shqipërisë në SPH së bashku me shtete anëtare dhe me mbështetjen e agjencive ligjzbatuese të BE-së është tashmë një realitet i pamohueshëm. Sipas faqes zyrtare të Eurojust, gjatë vitit 2023 prokurori ndërlidhës shqiptar është përfshirë në 116 çështje të reja, 22 mbledhje koordinuese dhe 1 qendër koordinuese, dhe në 22 SPH, 5 skuadra të reja në raport me vitin 2022 të mbështetura nga Eurojust (Prokurori i Përgjithshëm, 2024, f. 178; Këshilli i Ministrave, 2024, f. 16)

Sa i përket çështjeve konkrete, spikat veçanërisht pjesëmarrja e SPAK në operacione të suksesshme. Sipas njoftimeve në faqen e saj zyrtare, numërohen rreth 8 çështje ku hetimet janë kryer nëpërmjet SPH-ve, në veçanti në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet italiane, dhe nën koordinimin e Eurojust dhe me mbështetjen e Europol, kryesisht në fushën e narkotikëve – veprimtari e cila në rajon kryesohet nga rrjetet kriminale shqiptare (Europol, 2024, f. 29). Edhe Prokuroria e Tiranës së bashku me Prokurorinë e Barit, në një SPH nën koordinimin dhe me mbështetjen financiare të Eurojust, në vitin 2018 kanë realizuar një operacion të suksesshëm ku janë arrestuar 43 individë për trafikim narkotikësh, dhe janë sekuestruar 2300 kg marijuanë, kokainë, dhe heroinë, me një vlerë të përlllogaritur 15 milion Euro.

Ky përqëndrim lëndor evidentohet edhe në një publikim të nxjerrë rishtasi nga Eurojust, ku midis viteve 2019 dhe 2023, Shqipëria është përfshirë në 99 çështje trafikimi narkotikësh, duke marrë pjesë në 38 mbledhje koordinuese dhe 2 qendra koordinuese, si dhe në 17 SPH, ndër të cilat janë veçuar operacionet “Shpirti” dhe “Highway” (Eurojust, 2024, f. 6).

Lidhur me krimet e tjera, 3 operacione të bujshme janë kryer nëpërmjet SPH-ve në fushën e mashtrimit kompjuterik në qendrat e shërbimit të klientit (call center), ndër to operacionet “FRIDA-REFOX” dhe operacioni policor “HOAX”, me pjesëmarrjen e një numri të madh shtetesh. SPH gjithashtu janë përdorur me pjesëmarrjen e SPAK në operacione kundër kontrabandimit të qenieve njerëzore dhe mashtrimit në sistemin shëndetësor.

Së fundmi, vlen të përmendet edhe një operacion madhor i realizuar rishtasi, në 28 shkurt 2024, i koduar “Cluster Midas”, me pjesëmarrjen e SPAK dhe të 16 shteteve të tjera dhe me koordinimin e EPPO-s, në fushën e mashtrimit me TVSH dhe evazionit fiskal nga shitja e celularëve, kufjeve, dhe maskave mbrojtëse. Dëmi i kryer nga këto aktivitete llogaritet të jetë 195 milion Euro, dhe gjatë hetimit janë kryer mbi 180 kontrolle, dhe rreth 680 hetues të ndryshëm janë angazhuar për të realizuar këto veprime hetimore.

Krimet kryesore të cilat janë hetuar nëpërmjet SPH-ve me pjesëmarrjen e Shqipërisë dhe me mbështetjen e agjencive ligjzbatuese të BE-së gjatë vitit 2023 mund të paraqiten edhe në mënyrë grafike, ku siç kuptohet kryesojnë trafikimi i narkotikëve dhe krimi i organizuar (**Grafiku 1**), por duhet mbajtur parasysh se një SPH mund të hetojë më shumë se një vepër penale.

## Grafiku 1

SPH të mbështetura sipas krimeve kryesore – 2023 (Shqipëria pjesëmarrëse)



*Shënim.* Të dhënat e **Grafikut 1** janë marrë nga Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminaliteti për Vitin 2023, mars 2024, f. 179.

## Përfundime

Hetimet e përbashkëta si një skuadër janë kthyer tashmë në një formë bashkëpunimi ndërshtetëror mjaft të zakonshme, për shkak të fleksibilitetit dhe efektshmërisë hetimore që paraqet veprimtaria e një SPH-je, nxitur dhe mbështetur edhe nga agjencitë ligjzbatuese të BE-së. Veçohet këtu roli i Eurojust, për koordinimin dhe veçanërisht mbështetjen financiare që ofron për hetimet e kryera nga SPH-të, përfshirë ato me pjesëmarrjen e vendeve të treta jo-anëtare të BE-së, si Shqipëria, e cila prej vitesh tashmë ka dërguar një prokuror ndërlidhës pranë Eurojust, duke lehtësuar dhe mundësuar kështu bashkëpunimin e suksesshëm dhe të barabartë me shtetet anëtare.

Instrumentet e bashkëpunimit për krijimin e SPH-ve nga shtetet janë të shumta, duke filluar nga marrëveshjet shumëpalëshe, dypalëshe, përfshirë dhe ato me agjencitë e BE-së, por edhe legjislacioni kombëtar, dhe një zgjidhje mjaft praktike nga praktikuesit e SPH-ve është “ndërthurja e instrumenteve të bashkëpunimit”. Megjithatë, sa i përket legjislacionit kombëtar, paraqitet problematik parashikimi i kontrollit politik të Ministrisë së Drejtësisë për krijimin e SPH-ve me ligjin nr. 97/2021, pasi potencialisht konsideratat politike mund të bëhen pengesë për drejtësinë rajonale.

Protagonizmi i SPAK në SPH të shumta ka arritur një bilanc pozitiv pune për Shqipërinë, kryesisht në luftën kundër trafikimit të narkotikëve nga krimi i organizuar, por edhe për krime të tjera të rënda ekonomike, si operacioni më i fundit “Cluster Midas” në bashkëpunimin e parë dhe të suksesshëm me EPPO-n.

Në përfundim mund të thuhet se, Republika e Shqipërisë ka një kuadër normativ të përshtatshëm për krijimin e SPH-ve me shtete anëtare dhe agjenci ligjzbatuese të BE-së, që demonstron nga bilanci i çështjeve ndër vite, dhe ky kuadër do të vazhdojë të gjejë zbatim deri në anëtarësimin e plotë të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

## Referenca

1. Agjencia e Bashkimit Europian për Bashkëpunimin në Drejtësinë Penale (Eurojust), *International Cooperation in drug trafficking cases with third countries – Practical experiences of Liaison Prosecutors at Eurojust – April 2024*, Eurojust, prill 2024, <<https://data.europa.eu>>

[eu/doi/10.2812/35988](https://doi.org/10.2812/35988)>;

2. Agjencia e Bashkimit European për Bashkëpunimin në Drejtësinë Penale (Eurojust), *WB CRIM JUST – Enhancing cross-border cooperation in the Western Balkans for criminal justice*, Eurojust, tetor 2022, < <https://data.europa.eu/doi/10.2812/9428>>;
3. Agjencia e Bashkimit European për Bashkëpunimin në Drejtësinë Penale (Eurojust), *Guidelines on Joint Investigation Teams Involving Third Countries – June 2022*, Eurojust, qershor 2022, < <https://data.europa.eu/doi/10.2812/73766>>;
4. Agjencia e Bashkimit European për Bashkëpunimin në Zbatimin e Ligjit (Europol), *Decoding the EU's most threatening criminal networks*, Zyra e Publikimeve e Bashkimit European, 2024, <<https://data.europa.eu/doi/10.2813/811566>>;
5. Geraci, R. M., “Beyond Mutual Recognition: The Rules of Joint Investigation Teams”, *Optime*, vëllimi 13, nr. 2, 2021, ff. 29-40 < <https://doi.org/10.55312/op.v13i2>>;
6. Hoxha, A., *Ekstradimi dhe urdhri europian i ndalimit*, Shtëpia Botuese “Morava”, Tiranë 2011;
7. Ligj nr. 97/2021, datë 07.07.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10193, datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale””;
8. Ligj nr. 9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e Shteteve të Tyre Anëtare””;
9. Ndoci, L., *Bashkëpunimi Gjyqësor në Çështjet Penale në Bashkimin European - Roli i Eurojustit dhe i Mekanizmave të Tjerë Europiane të Bashkëpunimit Gjyqësor në Çështjet Penale*, Tezë Dizertacioni Doktorale, Instituti i Studimeve Evropiane, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2018, <<https://unitir.edu.al/bashkepunimi-gjyqesor-ne-ceshtjet-penale-ne-bashkimin-europian-rol-i-eurojustit-dhe-i-mekanizmave-te-tjere-europiane-te-bashkepunimit-gjyqesor-ne-ceshtjet-penale/>>, qasja e fundit më datë 02.05.2024;
10. Pradel, J., Corstens, G., Vermeulen, G., *E Drejta Penale Evropiane*, Botimet Papirus, Tiranë, 2009;
11. Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminaliteti për Vitin 2023, mars 2024, <[https://www.pp.gov.al/rc/doc/Raporti\\_1\\_PP\\_2023\\_date\\_28\\_03\\_2024\\_7383.pdf](https://www.pp.gov.al/rc/doc/Raporti_1_PP_2023_date_28_03_2024_7383.pdf)>, qasja e fundit më datë 02.05.2024;
12. Vendim i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë nr. 243, datë 17.04.2024 “Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2024”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 69, datë 22.04.2024;
13. < <https://spak.gov.al/>>;
14. < <https://www.eurojust.europa.eu/>>.